# Kontrolli i përdorimit të simbolit të akreditimit.

**Zbatues: Stafi, kryevlerësuesit dhe vlerësuesit e DPA**

**Përgjegjësi për zbatim: Drejtori i Drejtorisë së Akreditimit**

**Kontrolloi:** Menaxheri i Cilësisë
Ardita MELE

**Miratoi:** Drejtori i Përgjithshëm
Armond HALEBI

## 1 Qëllimi

Ky dokument përcakton mënyrën e kontrollit dhe verifikimit të përdorimit të simbolit dhe referencave tek akreditimi nga ana e organeve të akredituara.

## 2 Fusha e zbatimit

Kjo procedurë zbatohet nga stafi, kryevlerësuesit dhe vlerësuesit e DPA në lidhje me përdorimin
e logos së akreditimit. Gjithashtu kjo procedurë zbatohet kur OVK-të të cilat gëzojne statusin e akreditimit dhe përdorin simbolin ose referencën tek akreditimi. Kjo procedurë zbatohet edhe për kontrollin e përdorimit të markave ILAC-MRA dhe IAF MRA si dhe referencave tek EA-MLA.

## 3 Përgjegjësitë

Zbatimi i kësaj procedure është përgjegjesi e stafit, kryevlerësuesit dhe vlerësuesit e DPA dhe pëgjegjës për kontrollin e zbatimit është Drejtori i Drejtorisë së Akreditimit.

## 4 Referencat

Ky dokument bazohet :
-në standardin S SH ISO/IEC17011, paragrafi 4.3 “Kërkesa për organizmat e akreditimit që akreditojnë organizmat e vlerësimit të konformitetit”.
- Politiken e DA –PO-005
-Ligjin nr.116/2014
-Manualin e cilësisë DA-MC-001

## 5. Fjalori dhe shkurtime

Zbatohen ato terma dhe përkufizime që përdoren në dokumentat referuese te pikes 4.

## 6. Kontrolli dhe verifikimi i përdorimit të simbolit të akreditimit

Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit verifikon përdorimin e simbolit dhe referencave të akreditimit, referencave tek EA-MLA dhe markave ILAC-MRA dhe IAF-MRA në vizitat mbikëqyrëse/rivlerësuese. Kur gjatë vizitave konstatohet përdorim i gabuar i simbolit të akreditimit, kryevlerësuesi e vendos atë moskonformitet të cilin e klasifikon mbi bazën e rëndësisë dhe kohëzgjatjes së përdorimit të gabuar. Afati dhe mënyra e trajtimit për zgjidhjen e moskonformitetit do të jetë i njëjtë me atë të përcaktuar në procedurën DA-PT-001.

Në rastin e marrjes njoftim për përdorim të gabuar të simbolit, kryevlerësuesi përkatës organizon një vizitë shtesë për të verifikuar statusin e përdorimit të gabuar, kohëzgjatjen dhe rëndësinë. Kur

gjatë vizitave konstatohet përdorim i gabuar i simbolit të akreditimit, kryevlerësuesi e vendos atë moskonformitet. Afati dhe mënyra e trajtimit për zgjidhjen e moskonformitetit do të jetë i njëjtë me atë të përcaktuar në procedurën DA-PT-001.

Në rast se kryevlerësuesi konstaton që veprimet korrigjuese të propozuara nga OVK janë të pamjaftueshme për zgjidhjen e moskonformitetit, DPA i rekomandon OVK marrjen e masave të tjera.

Mos zgjidhja e moskonformitetit është shkak për pezullimin e akreditimit sipas procedurës DA-PT-006. Në rast se edhe pas pezullimit OVK përdor në mënyrë të gabuar simbolin e akreditimit atëherë DPA kërkon fillimin e procedurës së tërheqjes së akreditimit.

Në rast pezullimi dhe tërheqje të akreditimit, departamenti i zhvillimit publikon statusin e OVK në ëebsitin e DPA dhe listën e OVK të akredituara.

## 7. HISTORIKU

| Data e Ripunimit | Numri i Ripunimit | Autori | Përshkrimi i ndryshimeve të bëra |
|---|---|---|---|
| 30.10.2006 | 0 | A. Cuni | Varianti fillestar |
| 20.02.2008 | 1 | A.Fuga | Ndryshime në pikën 4 referencat dhe në pikën 9 |
| 22.12.2014 | 2 | E.Fyshku | Ndryshime header dhe ne pikat 2; 4; 6. |
| 20.05.2019 | 3 | B.Qazimi | Ndryshime ne piken 4 |
| | | | |